



Raporti vjetor

Viti Akademik
2018-2019

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Kolegji Universitar "Wisdom"

Tetor 2019

Tabela e Përmbajtjes

<i>Shkurtime</i>	2
I. Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë në KU”Wisdom”	4
II. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, (NjSBC) Funkcionet dhe përbërja	5
III. Plani vjetor i punës së NjSBC viti akademik 2018-2019.	7
IV. Realizimet dhe veprimtaria e NjSBC viti akademik 2018-2019.	9
V. Vlerësime të institucionit mbi sigurimin e cilësisë dhe rekomandime	22

Shkurtime

KU	Kolegji Universitar
NjSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
SBSC	Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë
IKZH	Instituti i Kërkim Zhvillimit “Wisdom”
MASR	Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë
NJKShMJ	Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë
ZBNjKJS	Zyra e Burimeve Njerëzore e Karrierës dhe Jetës Studentore

I. Sigurimi i Brendshëm dhe i Jashtëm i Cilësisë në Kolegjin Universitar “Wisdom”

a. Sigurimi i brendshëm i cilësisë¹

Bazuar në Statutin e Kolegjit Universitar “Wisdom”, sigurimi i brendshëm i cilësisë në Kolegjin Universitar “Wisdom” është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare në IAL. Ky vlerësim kryhet të paktën 1 (një) herë në 6 (gjashtë) vjet, por gjithashtu mund të kryhet sa herë shihet e arsyeshme, si vlerësim i përgjithshëm ose i pjesshëm. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në KU “Wisdom” realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:

- a) Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të KU“Wisdom”, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.
- b) Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të KU“Wisdom” dhe harton raportin përkatës të Vlerësimit të Brendshëm. Ky raport diskutohet në të gjitha njësitë e Kolegjit Universitar “Wisdom”, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.

b. Sigurimi i jashtëm i cilësisë²

Sigurimi i jashtëm i cilësisë së KU“Wisdom”, kryhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ose agjenci të tjera të autorizuar, me kërkesë të rektorit të institucionit, pas përfundimit të raportit të vlerësimit të brendshëm.

¹ Statuti i KU “Wisdom”, Neni 11 “*Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë*”.

² Po aty.

II. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Funkcionet dhe përbërja.

Ngritja dhe funksionimi i NjSBC, në Kolegjin Universitar "Wisdom", mbështetet në nenin 103 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në aktet nënligjore në zbatim të ligjit si dhe në Statutin e Kolegjit Universitar "Wisdom", Neni 27, *Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë*. NjSBC në KU "Wisdom" është një strukturë autonome, e përhershme e Kolegjit Universitar "Wisdom". Bazuar në Statut, përbërja e kësaj njësie është: 5 anëtarë, të cilët përfaqësojnë njësitë kryesore të KU "Wisdom", këshillin e studentëve, mund të bëjë pjesë dhe 1(një) anëtar në cilësinë e ekspertit të jashtëm³. Anëtarët e Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë emërohen nga Senati Akademik, nga radhët e personelit akademik, sipas propozimeve të bëra nga njësitë kryesore. Kryetari emërohet nga Rektori i Kolegjit Universitar "Wisdom".

NjSBC vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore, harton relacione dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë. Njësia ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ajo organizon punën në bashkëpunim me njësitë bazë, Komisionin për garantimin e standarteve të cilësisë, për kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas standartëve shtetërore të cilësisë, si dhe duke respektuar lirinë akademike në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies.

Në fillim të çdo viti akademik, NjSBC harton planin e veprimtarisë së saj në funksion ruajtjes dhe zhvillimit të procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. NjSBC, përgatit raportet vjetore periodike për procesin mësimor dhe adreson rekomandime. Organizimi dhe funksionimi i NjSBC dhe i SBSC në Kolegjin Universitar përcaktohen në rregulloren e saj.

Fushat e veprimit të NjSBC në KU "Wisdom" janë:

- Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë;

³ Po aty. Neni 27 "*Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë*"

- Subjektet e sigurimit të cilësisë;
- Cilësia në programet studimore;
- Efikasiteti i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe praktikat profesionale;
- Proçesi i kontrollit të dijeve;
- Burimet njerëzore, stafi dhe sigurimi i cilësisë;
- Studentët e Kolegjit Universitar “Wisdom”;
- Procesi i diplomimit;
- Veprimtaria administrative dhe financiare në kolegji;
- Biblioteka, tekstet, literatura e disponuar dhe laboratorët në universitet;
- Përkrahja në veprimtaritë jashtë-mësimore;
- Ambienti, hapësira në dispozicion dhe pajisjet;
- Përfshirja e studentëve në proçesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë.

Të dhëna për anëtarët e NJBSC

Tabela 1

	Anëtarët e NJBSC	Detyra që kanë në NJBSC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Edit Bregu	Kryetar (FD)	3
2	Dr. Jetmira Fekolli	Anëtar (FSHESH/ DP)	2
3	Msc. Loreta Çiço	Anëtar (FSHESH/DE)	3
4	Msc Flavia Kenaj	Anëtar (FD)	3
5	Sonila Grami	Anëtar (përqësues i studentëve)	3

III. Plani vjetor i punës së NjsBC viti akademik 2018-2019.

a. Detyra me karakter të përgjithshëm

- Rishikimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave për sigurimin e cilësisë;
- Rishikimi i politikave për sigurimin e cilësisë bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (Kreu X, Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë);
- Bashkëpunimi me NJSBC apo organizma të tjera të sigurimit të cilësisë të IAL-ve homologe me qëllim shkëmbim e përvojës për garantimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë;
- Monitorimi i punës me qëllim zbatimin e mekanizmave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në IAL;
- Bazuar në pikën 4 të Ligjit Nr. 80/2015, NJSBC bashkëpunon gjatë vitit me Zyrën e Burimeve Njerëzore Karrierës dhe Jetës Studentore me qëllim evidentimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve të KU “Wisdom”, për të vlerësuar efikasitetin e programeve të studimit të ofruara nga IAL jonë.

b. Detyra konkrete

- Përgatitja, miratimi dhe organizimi i pyetësorëve për studentët e programeve bachelor dhe master i shkencave;
- Përgatitja, miratimi dhe organizimi i pyetësorëve për pedagogët e KU “Wisdom”;
- Përgatitja, miratimi dhe organizimi i pyetësorëve për studentët e programeve të studimit me karakter profesional;
- Përpunimi i rezultateve nga pyetësorët e plotësuar nga studentët dhe

paraqitja e tyre me shkrim rektorit të IAL si dhe dekanëve të dy fakulteteve. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në rektorat dhe fakultetet apo departamentet përkatëse;

- Përpunimi i rezultateve nga pyetësorët e plotësuar nga pedagogët dhe paraqitja e tyre me shkrim rektorit të IAL si dhe dekanëve të dy fakulteteve. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në rektorat dhe fakultetet apo departamentet përkatëse;
- Hartimi i kalendarëve semestralë të kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore në ciklet e studimit: bachelor, master i shkencave si dhe programet me karakter profesional për vitin akademik 2018-2019;
- Realizimi i relacioneve mbi kalendarët e kontrollit semestralë të kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore në ciklet e studimit: Bachelor, master i shkencave si dhe programet me karakter profesional për vitin akademik 2018-2019;
- Organizimi në fund të çdo semestri i një takimi të studentëve me pedagogët e të dy Fakulteteve, Fakultetit të Drejtësisë dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore mbi ecurinë e studentëve sugjerimet dhe problematikat e tyre gjatë semestrave dhe viti akademik, me qëllim evidentimin dhe marrjen e masave për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimor;
- Menaxhimi i procesit të shpërndarjes së formatit të raporteve semestrale në Stafin Akademik të KU”Wisdom” dhe plotësimi nga çdo pedagog i raportit semestral, ku ndërmjet të tjerave pasqyrohen përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës (syllabusit), pjesëmarrja, kalueshmëria, nota

mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor për të ardhmen., etj;

- Përpunimi i të dhënave nga raportet semestrale të pedagogëve dhe realizimi i analizës SWOT. Realizimi i një raporti përmbledhës mbi pikat e forta dhe të dobta të institucionit. Formulimi i rekomandimeve përkatëse;
- Dhënien e informacionit sa më të qartë dhe këshillave të dobishme ndaj strukturave të tjera të institucionit në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të performancës akademike dhe administrative;
- Analizimi i rezultateve (provime, esse, kolokiume) të studentëve me qëllim vlerësimin e performancës së programeve universitare. Hartimi i një raporti i cili do të jetë pjesë integrale e raportit përfundimtar mbi vitin akademik që realizon NJSBC;
- Miratimi i formularit të vlerësimit të performancës akademike (Plotësohen nga Dekanët e Fakulteteve në fund të vitit akademik 2018-2019);
- Evidentimi i esesë më të mirë të studentëve me qëllim botimin e saj në Revistën Shkencore WISDOM;
- Realizimi i Intervistave informale me studentët. Zbardhja e tyre nqs evidentohen probleme dhe përcjellja e tyre në departamentet përkatëse;

IV. Realizimet dhe veprimtaria e NjSBC viti akademik 2018-2019.

Vlerat që karakterizuan veprimtarinë e NjSBC gjatë këtij viti akademik, bazuar edhe në rregulloren e saj janë :

- *Integriteti*, që do të thotë ndershmëri, objektivitet, aftësi, shmangie e konfliktit të intëresave në ushtrimin e veprimtarisë.
- *Pavarësia dhe Objektiviteti*, që do të thotë pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë dhe dhënie e opinioneve e gjykimeve objektive.
- *Profesionalizmi*, që do të thotë zbatim i standardeve profesionale me kujdesin e duhur profesional dhe korrektësi, mbështetur në metodologjitë dhe praktikat më të mira, si ato të universiteteve perëndimore.
- *Komunikim dhe Informim*, që do të thotë komunikim korrekt, objektiv, të qartë, konciz dhe konstruktiv gjatë veprimtarisë së tij.

Ku ka konsistuar veprimtaria e NjSBC:

A. Organizimi i Pyetësorit për Pedagogët

- Ky pyetësor është organizuar në përfundim të vitit akademik me qëllim krijimin e një panorame të përgjithshme që i jepet institucionit për të kuptuar më mirë nëpërmjet përgjigjeve pikpamjet që ka stafi akademik për institucionin në tërësi.
- Pyetësori është anonim, gjë që lejon shprehjen e mendimit të lirë nga ana e pedagogëve.
- Në përfundim të procesit nga NjSBC është hartuar edhe një relacion përmbledhës nga kordinatorët e njësisë i cili i është përcjellë Rektorit të KU “Wisdom” si dhe Dekanëve të dy Fakulteteve⁴.

Në përgjithësi do të veçonim:

⁴ Shkresa e Datës 15.07.2019 me Nr. 300 Prot.

Pikat e forta

- Një nga pikat e forta lidhet me faktin që në auditor ka një ekuilibër të drejtë mes kohës së kushtuar për disiplinat kurrikulare dhe angazhimit të studentëve në projekte.
- Pedagogët e brendshëm kanë përballuar mesatarisht një ngarkesë prej 10 deri 15 orë në javë duke mbështetur procesin mësimor dhe duke paraqitur një performancë të kënaqshme për sa i përket aspektit akademik dhe mësimdhënës.
- Kanë hartuar tezat e provimeve brenda afateve të parashikuara në Rregullore.
- Kanë marrë pjesë në evenimentet, seminarët e hapura të organizuara nga Kolegjit Universitar “Wisdom”.
- Kanë angazhuar studentët në përgatitjen e eseve sa më profesionale dhe sa më pranë tematikave dhe përmbajtjes së silabuseve të lëndëve përkatëse si dhe i kanë instruktuar që të bëjnë një prezantim sa më dinjitoz dhe mbrojtjen e punës së tyre.
- Pedagogët të cilët japin mësim në Programet Bachelor dhe Master i Shkencave në të dy Fakultetet kanë përfunduar me sukses hedhjen e notave të provimeve.
- Kanë përgatitur dhe punuar me slide duke i pasuruar me materiale të reja vashdimisht në mënyrë që ora mësimore të jetë sa më efektive dhe tërheqëse dhe për të qenë sa më koherent me zhvillimet më të fundit në fushat e studimit në të cilat janë të angazhuar dhe vazhdojnë të thellojnë studimet e tyre.

Pikat e dobëta

- Mungesat e studentëve, në disa lëndë të caktuara, të cilët frekuentojnë rregullisht seminarët ndërsa frekuentimin e leksioneve e kalojnë në plan të dytë.
- Pedagogët zakonisht ju përmbahen literaturës bazë por kërkohet që literatura të zgjerohet edhe më tej për të rritur nivelin e angazhimit të studentëve.

Mundësitë

- Takimet më të shpeshta mes pedagogeve dhe shefave të departamenteve për të diskutuar rreth problematikave të hasura dhe objektivave të punës do të ishin më frytdhënëse për rrijen e bashkëpunimit, dhe përmirësimin e cilësisë duke bërë që strukturat e koordinimit në rang institucioni të jenë më bashkëpunuese.

- Të gjithë pedagogët po realizojnë një punë intensive për të bindur studentët që të jenë të pranishëm në çdo orë leksioni dhe seminari duke u shpjeguar rëndësinë që ka pjesëmarrja në mësim në procesin e mësimnxënies.
- Përgatitja dhe punimi me slide duke i pasuruar me materiale të reja vashdimisht në mënyrë që ora mësimore të jetë sa më efektive dhe tërheqëse dhe për të qenë sa më koherent me literaturën dhe zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse të studimit mund të shërbejë për rritjen e atraktivitetit të orës së mësimi duke rritur edhe frekuentimin.
- Pjesëmarrja në aktivitetet ku janë të ftuar personalitete të ndryshme i aftëson studentët për të mësuar sa më shumë prej kulturës dhe njohurive të tyre.

Rekomandimet

- Staf i akademik i KU “Wisdom” ka paraqitur deri në këtë fazë të vitit akademik një profesionalizëm të lartë në kryerjen dhe përmbushjen me sukses të të gjithë angazhimeve të tyre por *kjo kërkon një angazhim serioz dhe korrekt, pjesëmarrje aktive në të gjitha proceset mësimore, kërkimore dhe administrative* duke patur si primare rritjen e performancës gjatë orës mësimore.

Nga mendimet e shprehura prej pedagogëve që u bënë pjesë e anketimit ishin në përgjithësi me sens pozitiv duke qenë se ata vlerësojnë në më të shumtën e rasteve me përgjigjet **Po** për shumicën e pyetjeve që kishin të bënin me marrëdhënien e tyre me institucionin, në lidhje me marrëdhënien e tyre me kolegët apo në raportin e tyre të ndërsjelltë me drejtuesit duke pranuar në këtë mënyrë se janë të kënaqur me bashkëpunimin në tërësi midis tyre dhe institucionit. Kjo është një shprehje se jemi në drejtimin e duhur për sa i përket organizimit dhe strukturës së përgjithshme të Kolegjit Universitar “Wisdom”, po gjithashtu krijimi i një mjedisi të përshtatshëm akademik dhe shkencor është në mbështetje të plotë të lirisë akademike dhe në nxitje të rritjes së cilësisë së brendshme të institucionit tonë arsimorë. Sigurisht në të ardhmen do të bëhen përpjekje edhe më të mëdha për të përforcuar mekanizmat akademik e didaktik për të rritur standartet e mësimdhënies e mësimnxënies tonë si dhe për të inkurajuar bashkëpunimin e brendshëm institucional.

B. Organizimi i Pyetësorit për Studentët

- Ky pyetësor është organizuar çdo semestër, pra 2 herë gjatë vitit akademik 2018-2019. Përmbajtja e pyetjeve ka qenë jo vetëm me pyetje për pedagogët, por edhe për çështje të tjera, si lidhur me leksionet, komunikimin student-pedagog, infrastrukturën mësimore etj.
- Përgjithësisht tendenca ka qenë për të marrë mendime për aspektet kryesore të zhvillimit të performancës dhe cilësisë.
- Numri i studentëve të anketuar ndryshon nga njëri anketim në tjetrin, në varësi dhe të studentëve të pranishëm në momentin e kryerjes.
- Të gjithë pyetësorët janë përpunuar dhe mendimet e shprehura i janë paraqitur me shkrim rektorit (për dijeni dekanëve të dy fakulteteve)⁵. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në senat.

Në përgjithësi do të veçonim:

- Gjatë zhvillimit të procesit të anketimit mënyra e menaxhimit të pyetësorëve ishte transparente dhe përzgjedhja e studentëve ishte e rastësishme. U respektua një kohë e përshtatshme në një ditë normale mësimi për kryerjen e anketimit, ku studentët plotësuan me vullnet të lirë dhe të plotë rubrikat e pyetësorëve.
- Për sa i përket pjesëmarrjes së studentëve, në Pyetësorin e hartuar posaçërisht për të marrë mendimin e tyre, ajo ka qenë e kënaqshme në krahasim me numrin e përgjithshëm të studentëve të anketuar.
- Nga analiza e përgjithshme e përgjigjeve të mara prej pyetësorëve u vërejt se në përgjithësi për të gjitha degët dhe vitet, marrëdhënia institucion-student është e mirë, studenti ndihet mirë si me anën infrastrukturale ashtu edhe me atë didaktike dhe akademike. Nuk ka pakënaqësi në lidhje me gjithë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, po ashtu ka një përputhshmëri midis pritshmërive me të cilat studenti aksesohet në institucion dhe asaj se çfarë institucioni ofron në realitet për të mbuluar të gjitha shërbimet e tij akademike dhe jo vetëm.
- Për sa i përket fushës së pakënaqësive të shfaqura prej studentit u vu re se këta të fundit

⁵ Shkresa e Datës 15.07.2019 me Nr. 299 Prot.

nuk kishin pakënaqësi të shprehura në lidhje me asnjë prej proceseve të ofruara prej KU “Wisdom” por nga prej disa prej tyre është shprehur sugjerimi që biblioteka e intitucionit të posedojë edhe më shumë tekste.

- Në përgjithësi studentët janë të kënaqur me atë që ju ofrojnë kurset e studimit, me mjetet e nevojshme për ushtrimet praktike (dokumentacioni, pajisjet informatike, instrumentat, mjete laboratorike, etj.) pasi që ato janë të disponueshme dhe në masën e duhur, me atë që ju ofrohet për sa j’u përket institucioneve/qendrave/strukturave ku zhvillohet praktika profesionale (stazh, punë laborator, ushtrime, projekte, etj. Po ashtu ata shfaqën në përgjithësi të kënaqur me përshtatshmërinë e sallave në të cilat zhvillohet mësimi (ka vënde, shikohet, dëgjohet, etj).

Në përgjithësi leksionet në secilin prej kurseve kanë rezultuar të qarta të bazuar në një formim shkencor të kënaqshëm dhe profesional duke i bërë programet e këtyre kurseve interesante dhe tërheqëse për studentin, duke stimuluar edhe pjesëmarrjen aktive të studentëve nga pedagogët e lëndës dhe sigurisht duke rritur komunikimin midis vetë studentit dhe pedagogut.

C. Kalendarët semestralë të Kontrollit të Cilësisë. NjSBC.

- NjSBC ka hartuar kalendarin e kontrollit të brëndshëm të cilësisë për programet mësimore të semestrit të parë⁶ dhe të dytë⁷ për vitin akademik 2018-2019.
- Në bashkëpunim me departamentet dhe Komisionin për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe në përputhje me lirinë dhe autonominë akademike, është asistuar në seminarët dhe leksionet për lëndët përkatëse sipas një kalendari të paracaktuar nga vetë Njësia.
- Janë mbajtur relacionet përkatëse dhe gjatë muajve Prill⁸ dhe Korrik⁹ 2018 janë hartuar relacione përmbledhës narrative mbi ato çfarë është vërejtur gjatë kontrollit të çdo pedagogu, ndihma e ndërsjellët, shkëmbimi i përvojave ndërmjet pedagogëve

⁶ Shkresa e Datës 20.11.2018 me Nr. 104 Prot.

⁷ Shkresa e Datës 02.05.2019 me Nr. 226 Prot.

⁸ Shkresa e Datës 25.03.2019 me Nr. 193/2 Prot.

⁹ Shkresa e Datës 15.07.2019 me Nr. 298 Prot.

për metodologjinë e mësimdhënies si dhe plotësimi nga studentët i pyetësorit me rubrika të ndryshme në lidhje me mësimdhënien / mësimnxënien për pedagogët, të cilat i kanë shërbyer sigurimit të cilësisë. Kjo është një veprimtari e cila besojmë që ka ndikuar në shërbim të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në KU “Wisdom”.

Sipas raporteve të hartuara në mënyrë të përmbledhur mund të konkludojmë se :

- *Janë vërejtur angazhime serioze nga lektorët në orët e leksioneve, ku ka mbizotëruar një nivel i lartë i kompetencës mësimore dhe profesionalizmit nga pedagogu për zhvillimin e lëndës, si dhe është konstatuar një formë moderatore e bashkëpunimit me studentët në orët e seminareve.*

- *Pedagogët kanë asistuar në sigurimin e cilësisë së orës së mësimi me anë të mjeteve bashkëkohore të mësimi, duke përdorur teknologjinë e avancuar Video Projektor PowerPoint, Dvd, Cd-Roms, alternuar këto me eksperiencën e vlefshme dhe të dukshme të pedagogëve në shpjegimin e koncepteve teorikë dhe punimeve praktike në auditorë si dhe formën tradicionale të punës me libra dhe materiale shtesë (revista dhe artikuj shkencorë, cikle ushtrimesh, botime kërkimore bashkëkohore) ofruar nga biblioteka e KU “Wisdom”.*

- *Nuk ka pasur raste të mungesës së profesionalizmit në ushtrimin e detyrës së pedagogut. Asnjë rast i evidentuar.*

D. Në fund të kontrolleve për të gjitha lëndët e semestrit, është organizuar një takim i përbashkët i Fakulteteve dhe departamenteve përkatës, përfaqësues nga NjSBC me studentët, ku janë ballafaquar me mendimet dhe opinionet e gjithësecilit në lidhje me problematika dhe sugjerime të mundshme Ky mekanizëm i cilësisë ka synuar mbi të gjitha përveç rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në KU “Wisdom”, ti afrojë edhe më tepër studentët me stafin akademik, duke i bërë ata më tepër pjesë të proceseve organizative dhe vendimarrëse në Institucionin tonë. Në përfundim të takimeve në mbyllje të semestrit të parë¹⁰ dhe në mbyllje të

¹⁰ Shkresa e Datës 07.02.2019 me Nr. 162 Prot. Shkresa e Datës 07.02.2019 me Nr. 160 Prot. Shkresa e Datës 09.02.2019 me Nr. 566 Prot.

semestrin të dytë¹¹, nga ana e departamenteve janë realizuar edhe relacionet përkatëse mbi takimet ku janë evidentuar edhe pikat më të rëndësishme të diskutuara.

Në këto relacione në mënyrë të përmbledhur do të veçonim:

Diskutimet në të gjitha takimet e zhvilluara u orientuan kryesisht në lidhje me opinionet, mendimet dhe sugjerimet e studentëve të të fakulteteve në lidhje me procesin mësimor.

Disa nga tematikate trajtura ishin:

- Aktivizimin e studentëve në projekte të ndryshme
- Mundësia e botimeve në revista shkencore, ftohen studentët vazhdimisht
- Rritja e numrit të titujve, më shumë tituj librash të huaj përsa i përket literaturës ndihmës
- Zhvillimi i leksioneve gjatë II semestrave
- Zhvillimi i seminareve gjatë II semestrave
- Aktivizimin e studentëve në aktivitete kërkimore-shkencore
- Zhvillimin e aktiviteteve jashtë-mësimore

Stafi akademik ka dëgjuar me kujdes dhe vëmendje zërat e studentëve duke këshilluar që tu jepet më shumë rëndësi frekuentimit të procesit mësimor nga ana e studentëve dhe përfshirjes sa më aktive në jetën studentore.

Stafi Akademik është duke bashkëpunuar ngushtë me:

- Komisionin për garantimin e standartëve të cilësisë
- Komisionin për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulën
- Komisionin për marrëdhëniet me studentët, publikun dhe kordinimin
- Njësitë e kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë

¹¹ Shkresat e Datës 07.06.2019 me Nr. 278/1-278/2- 278/3 Prot.

- si dhe Institutin për Kërkim dhe Zhvillim Wisdom me qëllimin e vetëm për të rritur nivelin e angazhimit të studentëve në aktivitete të ndryshme të karakterit shkencor por edhe të pjesëmarrjeve në trajnime dhe projekte me qëllim që tu jepet mundësia studentëve të Fakultetit tonë që të jetojnë dhe eksperiencën të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në kuadër të projekteve të ndryshme (Erasmus plus, training course etj)

Diskutimet me studentët dhe stafin akademik të KU"Wisdom" do të vazhdojnë në mënyrë periodike edhe përgjatë vitit akademik 2019-2020, për të patur një komunikim të vashdueshëm dhe koherent të problematikave, sugjerimeve, udhëzimeve etj.

E. Raporti semestral për çdo pedagog.

Relacioni në mbyllje të sezonit të provimeve të Semestrit të I-rë¹² dhe të II-të¹³, për realizimin e programeve të lëndëve dhe plotësimi nga çdo pedagog i raportit semestral, ku ndërmjet të tjerave pasqyrohen përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës (syllabusit), pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor për të ardhmen., etj

Mund të themi se për sa i përket frekuentimit në të dy fakultetet ka kapur mesatarisht shifrat e 70-80%, kalueshmëria shifrat e 80-95%, ndërsa për sa i përket analizës SWOT të realizuar është dale në konkluzionin se pikat e forta ishin:

- Përdorimi dhe shfrytëzimi i literaturës jo vetëm të detyrueshme dhe asaj në gjuhën shqipe por edhe i literaturës bashkëkohore me tituj të huaj e të rëndësishëm për secilën prej fushave të studimit.
- Realizimi i objektivave të programit të lëndës në mënyrë të kënaqshme.

Si pika të dobëta u evidentuan

¹² Shkresa e Datës 25.03.2019 me Nr. 193 Prot.

¹³ Shkresa e Datës 15.07.2019 me Nr. 297 Prot.

- Kërkesa e llogarisë duhet të jetë me e madhe.
- Pjesmarrja e ulët e studentëve në procesin e mësimdhënies.

Përmirësime:

- Motivimi i studentëve dhe mbështetja e tyre të rrisin pritshmëritë për përvetësimin cilësor të programit të studimit u dalluan si mundësi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në raportin pedagog student.

F. Intervistat me studentët.

Intervistat jo formale me studentët, për procesin mësimor në përgjithsi dhe për probleme të veçanta që studentët hasën përgjatë vitit akademik 2018-2019.

G. Performanca e studentëve.

Ajo arrihet të vëzhgohet përmes vënies në funksionim të një mekanizmi monitorues. Ky mekanizëm, që në vetvete përbën edhe një gjetje apo tregues të cilësisë, mbështetet mbi pesë shtylla apo elementë që konsistojnë në:

- Vijueshmërinë e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit
- Nivelin cilësor të angazhimit të tyre në procesin e debatit dhe shkëmbimit praktik të opinioneve gjatë zhvillimit të orëve të seminareve, përmes ballafaqimit të kazuseve të importuara nga praktika gjyqësore, administrative si dhe psikologjike.
- Detyrën e Kursit e cila përbën domethënien akademike të studentit. Përmes organizimit dhe shpërndarjes së disa tematikave në grupe te veçanta është siguruar reagimi i studentëve për tema të përbashkëta, duke rritur ndjeshëm edhe shanset e identifikimit të nivelit të cilësisë së tyre në lidhje me shprehjen dhe kohezionin e dijeve dhe të dhënave të tyre akademike.
- Kolokiumin, i cili përfaqëson arritjen e studentit në nivel semestral. Në hartimin e tezave në këtë “ballafaqim student-pedagog” i është kushtuar vëmendje e veçantë

arritjes së vlerës praktike të këtyre tezave. Mënyra e testimit gojor ose me shkrim e studentëve ka krijuar një avantazh të padiskutueshëm si për studentin, i cili ka pasur në posedim hapësirën e nevojshme shprehëse të dijeve të tij, ashtu dhe për pedagogun që ka ushtruar në mënyrë të ndërsjellët një kontroll më të gjerë dhe më efikas mbi përgatitjen e studentit.

- Testin përfundimtar, që realizohet me anën e provimit të përgjithshëm apo të punimit për mbrojtjen e diplomës:

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar sipas niveleve dhe programeve të studimit;

Programi Bachelor 2018-2019	Numri i studentëve	Programi Master i Shkencave 2018-2019	Numri i studentëve
“Drejtësi”	50	“ E drejtë Penale”	20
“Psikologji”	8	“ E drejtë Civile “	29
“Menaxhim Biznesi	34	“Psikologji shkollorë dhe edukimi”	18
“Financë-Bankë”	30	Administrim Bisnesi	21
Gjithsej	122	Gjithsej	88
Gjithsej numri i studentëve të rregjistruar në Programet e ciklit të parë “Bachelor” dhe Ciklit të Dytë “ Master i Shkencave “ = 210			

Numri i të diplomuarve sipas niveleve dhe programit të studimit;

Programi Bachelor 2018-2019	Numri i të diplomuarve	Programi Master i Shkencave 2018-2019	Numri i të diplomuarve
“ Drejtësi”	30	“ E drejtë Penale”	17
“ Psikologji”	11	“ E drejtë Civile dhe Tregtare “	21
“Menaxhim Biznesi	31	“Psikologji shkollorë dhe edukimi”	7

“Financë-Bankë”	9		
Gjithsej	81	Gjithsej	45
Totali i të diplomuarve në Programet e ciklit të parë dhe të dytë = 126			

Numri i studentëve të transferuar (shoqëruar me informacion mbi institucionin e parë, programin e studimit dhe semestrin ku transferohet);

VITI AKADEMIK 2018-2019								
Transferime	Bachelor në Drejtësi	Bachelor në Menaxhim Biznesi	Bachelor në Financë	Bachelor në Psikologji	Master i Shkencave “ E drejtë Penale”	Master i Shkencave “ E drejtë Civile dhe Tregtare “	Master i Shkencave “Psikologji shkollorë dhe edukimi “	Master i Shkencave “Administrim Biznesi “
Ndërmjet Universiteteve	28	19	23	3	4	2	1	21
Gjithsej Transferime Bachelor	73							
Gjithsej Transferime Master	28							
Gjithsej Total	94							

Pagesat totale (tarifat e studimit, regjistrimit etj.) për secilin program studimi në bazë të kohëzgjatjes së studimit;

- Tarifat e studimit për vitin akademik 2018-2019 ishin si më poshtë:

NR.	CIKLI I STUDIMEVE	EMËRTIMI I PROGRAMIT	TARIFA E STUDIMIT
1	Bachelor	Drejtësi	1500€
2	Bachelor	Psikologji	1500€
3	Bachelor	Menaxhim Biznesi	1500€
4	Bachelor	Financë Bankë	1500€
5	Master i Shkencave	E drejtë Civile dhe Tregtare	1700€
6	Master i Shkencave	E drejtë Penale	1700€
7	Master i Shkencave	Psikologji Shkollore dhe Edukimi	1700€
8	Master i Shkencave	Administrim Biznesi	1700€

- Tarifat e studimit për vitin akademik 2019-2020 janë si më poshtë¹⁴:

NR.	CIKLI I STUDIMEVE	EMËRTIMI I PROGRAMIT	TARIFA E STUDIMIT
1	Bachelor	Drejtësi	1500 €
2	Bachelor	Psikologji	1500 €
3	Bachelor	Menaxhim Biznesi	1500 €
4	Bachelor	Financë Bankë	1500 €
5	Master i Shkencave	E drejtë Civile dhe Tregtare	1700€
6	Master i Shkencave	E drejtë Penale	1700€
7	Master i Shkencave	Psikologji Shkollore dhe Edukimi	1500€

¹⁴ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Neni 32, Raportimi.

8	Master i Shkencave	Administrim Biznesi	1700€
9	Prog.me karakter profesional	Agjent i pasurive të paluajtshme	1200€
10	Prog.me karakter profesional	Asistent juridik	1200€
11	Prog.me karakter profesional	Asistent administrativ	1200€
12	Prog.me karakter profesional	Asistent social	1200€

E. Ndhma e ndërsjellët ndërmjet pedagogëve, shkëmbimi i eksperiencave.

- Element i rëndësishëm i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është vlerësuar edhe ndihma e ndërsjellët ndërmjet pedagogëve për metodologjinë e mësimdhënies, si dhe kontrolli, në përputhje me parimet e lirisë akademike, të seminareve, të leksioneve, të detyrave të kursit dhe të praktikës mësimore, duke ofruar alternative për zgjidhjen e problemeve.
- Janë organizuar nga ana e departamenteve takime informuese me pedagogët e rinj për metodologjinë e mësimdhënies dhe për probleme të tjera që do të shërbejnë rritjes së cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies, në funksion të rritjes së cilësisë së procesit mësimor. (standart dhe performancë edhe për stafin e ri të punësuar përgjatë vitit akademik 2018-2019)

F. Veprimtaria kërkimore-shkencore e stafit si dhe mundësi për angazhim të studentëve.

- Në bashkëpunim me Njësitë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë është miratuar formati mbi raportimin e veprimtarisë për kërkime shkencore të stafit për vitin akademik 2018 -2019. Qëllimi i NjSBC është dhe do të jetë padiskutim edhe vlerësimi i përformacës dhe cilësisë së kërkimit shkencor të stafit akademik dhe krijimi në bashkëpunim me Njësitë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë i mekanizmave për ta rritur dhe zhvilluar angazhimin e stafit në aktivitete shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Bazuar në Planin e Veprimtarisë Kryesore të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të

Cilësisë për vitin akademik 2018-2019, është kërkuar Evidentimi i esesë më të mirë të studentëve në bashkëpunim me Departamentet, Pedagogët, me qëllim botimin e saj në Revistën Shkencore “Wisdom”, realizuar¹⁵.

Në përfundim procesit mësimor pra të vitit akademik, është hartuar edhe ky Raport përmbledhës për titullarin e institucionit dhe titullarët e njësisë kryesore mbi ecurinë e procesit mësimor, pikat e forta dhe të dobëta, sugjerimet përkatëse. Qëllimi i realizimit të këtij raporti ka qenë evidentimi i të dhënave të mbledhura nga të gjitha mekanizmat për matjen e cilësisë, dhënia e propozimeve për përmirësimin dhe rritjen e vazhdueshme të standartit të cilësisë.

V. Vlerësime të institucionit mbi sigurimin e cilësisë dhe rekomandime

Institucioni ynë ndodhet në fazën e rritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të standardeve ekzistuese të cilësisë në kuadër hapësirës mbarë evropiane të Arsimit të Lartë por edhe të përafrimit të politikave dhe strategjive të reja në lidhje me kriteret e cilësisë. Një dokument shumë i rëndësishëm që ka shërbyer si udhërrëfyes i mekanizmave tona të cilësisë në IAL ka qenë Kodi i Cilësisë¹⁶.

Fenomeni i cilësisë, i pranishëm, mund të grupohet në disa procese, që kanë karakterizuar politikën e cilësisë së ndjekur nga institucioni si:

- Aktivitetet e mësimdhënies;
- Aktivitete të karakterit kërkimor-shkencor;
- Performanca e studentit;
- Marrëdhëniet me jashtë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Proceset administrative dhe ndihmëse;

Për sa i përket *elementit të mësimdhënies*, janë konsoliduar përpjekjet për zhvillimin cilësor të leksioneve dhe seminareve dhe në një atmosferë sa më bashkëkohore, ku padyshim teknologjia si

¹⁵ Studentja e Fakultetit të Drejtësisë Erjona Keta ka botuar në bashkëpunim me Dr. Spiro BUDO pas pjesëmarrjes në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Intercultural studies in the field of justice and social sciences” punimin: “*State Jurisdiction for Criminal offenses with International Elements and Its Sanction by Albanian Penal Code*”.

¹⁶ Kodi i cilësisë së arsimit të lartë, i miratuar me VKM Nr.531 datë 11.09.2018.

dhe metodat e adoptuara luajnë një rol parësor. Përgjithësisht sipas rezultateve të anketimeve, vihet re aplikimi i metodave të mësimdhënies intensive që synojnë një përthithje integrale të dijeve nga ana e studentëve dhe një angazhim pjesëmarrjeje në nivel më të gjerë. Vënia në praktikë e dijeve të përftuara nga studentët është projektuar si prioriteti kryesor . Për këtë arsye në procesin e mësimdhënies janë ofruar personalitete të rëndësishëm në fushat e drejtësisë, ekonomisë dhe psikologjisë, të cilët ju kanë ofruar eksperiencën e tyre praktike studentëve duke i sjellë studentët më pranë nevojave praktike të tregut të punës si dhe duke garantuar cilësi të dijeve të marra në auditoret tona.

Në lidhje me *performancën e studentëve* është adoptuar formula që siguron një zhvillim të vazhdueshëm të performancës së studentit, si dhe rritje të cilësisë së bashkëveprimit student – pedagog. Performanca e studentëve vëzhgohet përmes vënies në funksionim të mekanizmave monitorues të përmendur edhe më sipër në këtë raport.

Për sa i përket këndvështrimit të marrëdhënieve me jashtë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, mund të cilësojmë se KU “Wisdom” po zhvillon përpjekjet e tij për shtrirjen e projekteve të bashkëpunimit dhe anëtarësimit me IAL brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimi me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, angazhime në projekte të ndryshme në fushën e arsimit universitar, zgjerimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani të mirënjohura biznesi, institucione dhe sektorë të administratës publike e etj.,

Në lidhje me elementin e *aktiviteteve kërkimore-shkencore*, ka pasur një politikë konstante në lidhje me zhvillimin dhe zgjerimin e hapësirave kërkimore shkencore brenda institucionit tonë. Fasilitete dhe impute të tilla si p.sh biblioteka, pasurimi i saj me librat më bashkëkohore, biblioteka online, interneti, prania e vazhdueshme e lektorëve të huaj, kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e aksesit të pedagogeve ndaj zhvillimeve më të fundit në plan kombëtar dhe ndërkombëtar mbi fushat e tyre të studimit. Po kështu është adoptuar përmes një politike të qëndrueshme pasurimi i silabuseve me literaturë relevante vendase dhe të huaj, por pavarësisht

arritjeve, institucioni është i përgjegjshëm për nivelin e sfidave të pritshme dhe për të cilat kërkohet hartimi i strategjive të qarta dhe të qëndrueshme.

Gjatë vitit akademik 2018-2019 përpjekjet për zhvillimin e marrëdhënieve me jashtë të institucionit tonë i kemi parë të përqendruara në disa fusha që janë:

1. Përafrimi i programeve të lëndëve me standardet e universiteteve të ndryshme perëndimore;
2. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL të ndryshme (kryesisht ato perëndimore) dhe qendra kërkimore apo institute të kërkimit shkencor;
3. Shkëmbimi i përvojave në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
4. Nxitja e punës kërkimore tek stafi dhe mbështetja e stafit për punën kërkimore dhe sigurimi i pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare shkencore, konferenca ndërkombëtare shkencore, botime në revista me faktor impakti etj;
5. Bërjen të mundur të ardhjes pranë institucionit tonë të profesorëve të huaj si profesor vizitorë (zhvillimi i mëtejshëm i marrëveshjes së bashkëpunimit me CILS por edhe të tjera organizata).

Në lidhje me *proceset administrative e ndihmëse*, mund të thuhet se nga pikëpamja administrative e procesit të cilësisë, i është vënë theksi zhvillimeve të vazhdueshme me qëllim evidentimin e IAL tonë si një IAL elitare dhe e konsoliduar në vend.

Për sa i përket *këndvështrimit tonë*, gjykojmë që disa prioritetë duhet të mbahen nën një konsideratë të vazhdueshme:

- Duhet të përmirësohen linjat e komunikimit, si në aspektin e stafit akademik ashtu edhe atë të studentëve;
- Nga të dhënat e evidentuara Institucioni duhet të punojë me rritjen dhe larmishmërinë e aktiviteteve mësimore dhe jashtë-mësimore që do të ndikojnë në rritjen e nivelit të frekuentimit në leksione dhe seminare;
- Duhet të nxitet pjesëmarrja e stafit akademik në sa më shumë projekte apo aktivitete të

karakterit shkencor me qëllim që praktika e marrë nga stafi të shërbejë në nxitjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit të mësimdhënies;

- NjSBC bazuar në Legjislacionin për arsimin e lartë në vend, standartet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë (SUE), aktet rregullatore të miratuara në institucion, etj si dhe në Kodin e cilësisë së arsimit të lartë të miratuar me VKM Nr.531 datë 11.09.2018, do të punojë në vazhdimësi referuar kritereve të përcaktuara në të duke dhënë mendime, propozime me qëllim zhvillimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë në KU "Wisdom".

Gjykojmë që puna serioze dhe e vazhdueshme në lidhje me përsosjen e këtyre prioriteteve do të shërbejë në zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të cilësisë në të gjitha organet IAL-së.

Hartoi,

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. Dr. Edit BREGU
2. Dr. Jetmira FEKOLLI
3. Msc. Loreta ÇIÇO
4. Msc Flavia KENAJ
5. Sonila Grami (*studente*)

Tiranë më, 01 Tetor 2019